

LIGJ PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PER THEMELIMIN E KOMISIONIT SHTETEROR PER VENDIMARRJE NE PROCEDURE ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURE TE MARREDHENIES SE PUNES NE SHKALLE TE DYTE

Nen
i 1

Ne Ligjin per themelimin e Komisionit Shteteror per Vendimmarrje ne Procedure Administrative dhe Procedure te Marredhenies se Punes ne Shkalle te Dyte ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 51/11 dhe 148/13), ne nenin 1 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Komisioni Shteteror eshte kompetent per zgjidhjen e ankesave kunder aktvendimeve te miratuara ne shkalle te pare nga Komisioni per Letra me Vlere."

Paragrafet (3), (4) dhe (5) behen paragrafe (4),(5) dhe (6).

Nen
i 2

Ne nenin 2 ne paragrafin (2) fjala "shteterore" zevendesohet me fjalen "administrative".

Nen
i 3

Ne nenin 3 ne paragrafin (2) fjalet: "permes konkursit publik" shlyhen. Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Per emerimin e kryetarit dhe anetareve te Komisionit Shteteror publikohet shpallje publike ne se paku tri gazeta ditore te cilat botohen ne te gjithe territorin e Republikes se Maqedonise, nga te cilat nje nga gazetate qe botohen ne gjuhen qe e flasin se paku 20% nga qytetaret qe flasin gjuhe zyrtare te ndryshme nga gjuha maqedonase."

Paragrafi (3) behet paragraf (4).

Paragrafi (4) i cili behet paragraf (5) ndryshohet si vijon:

"(5) Si kryetar i Komisionit Shteteror emerohet personi i cili i permbush kushtet ne vijim:

- 1) eshte shtetas i Republikes se Maqedonise;
- 2) ne momentin e emerimit me aktgjykim te plotfuqishem gjyqesor nuk i eshte shqiptuar denda ose sanksion kundervajtes ndalim te ushtrimit te profesionit, veprimtarise ose detyres;
- 3) ka fituar se paku 240 kredi sipas SETK ose ka kryer shkallen e arsimit VII/1 nga sfera e drejtesise;
- 4) te kete minimum pese vjet pervojave pune ne pune administrative;
- 5) posedon nje nga certifikatat ose deshmite e pranuar nderkombetare vijuese per njohje aktive te gjuhes angleze jo me te vjeter se pese vjet;

- TOEFEL IBT-se paku 74 pike,
- IELTS (IELTS) – se paku 6 pike,
- ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - se paku niveli B2 (B2),
- FCE (FCE) (Cambridge English: First) – te dhene,
- BULATS (BULATS) – se paku 60 pike ose
- APTIS (APTIS) – se paku niveli B2 (B2) dhe

6) te kete dhene testin psikologjik ose testin e integritetit."

Paragrafi (5) i cili behet paragraf (6) ndryshohet si vijon:

(6) Si anetar i Komisionit Shteteror emerohet personi i cili i permbush kushtet ne vijim:

- 1) eshte shtetas i Republikes se Maqedonise;
- 2) ne momentin e emerimit me aktgjykim te plotfuqishem gjyqesor nuk i eshte shqiptuar de nim ose sanksion kundervajtes ndalim te ushtrimit te profesionit, veprimtarise ose detyres;
- 3) ka fituar se paku 240 kredi sipas SETK ose te kete kryer shkallen VII/1;
- 4) ka minimum pese vjet pervoje pune ne pune administrative;
- 5) posedon nje nga certifikatat ose deshmite e pranuar nderkombetare vijuese per njohje a ktive te gjuhes angleze jo me te vjeter se pese vjet:

- TOEFEL IBT-se paku 74 pike,
- IELTS (IELTS) – se paku 6 pike,
- ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - se paku niveli B2 (B2),
- FCE (FCE) (Cambridge English: First) – te dhene,
- BULATS (BULATS) – se paku 60 pike ose
- APTIS (APTIS) – se paku niveli B2 (B2) dhe

6) te kete dhene testin psikologjik ose testin e integritetit."

Paragrafet (6) dhe (7) behen paragrafe (7) dhe (8).

Nen
i 4

Kryetari dhe anetaret e Komisionit Shteteror te emeruar deri ne ditën e fillimit me zbatimin e nen it 3 te ketij ligji vazhdojne ta ushtrojne funksionin deri ne skadimin e mandatit per te cilin jane em eruar.

Nen
i 5

Dispozitat e nenit 1 te ketij ligji do te fillojne te zbatohen me fillimin e zbatimit te dispozitave nga nenet 8, 9, 13 dhe 15 te Ligjit per ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit per letra me vlere ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 188/13).

Dispozitat e nenit 2 te ketij ligji do te fillojne se zbatuari me ditën e fillimit te zbatimit te Ligjit per nepunesit administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 27/14) dhe Ligjit per te punesuarit ne sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 27/14).

Dispozitat e nenit 3 te ketij ligji do te fillojne te zbatohen pas nje viti nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji, pervec dispozitave qe kane te bejne me kushtin per njohjen e gjuhes se huaj te cilat do te fillojne se zbatuari pas dy vitesh nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Nen
i 6

Ky ligj hyn ne fuqi ne ditën e tete nga dita e botimit ne "Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise".